




INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVO LAW INSTITUTE
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

05/2020

PALIGJSHMËRIA E VENDIMEVE TË DOMOSDOSHME PËR COVID-19



(ANALIZË E KUSHTETUTSHMËRISË DHE
LIGJSHMËRISË SË VENDIMEVE PËR COVID-19)

PRISHTINË, PRILL 2020

Autor: Gzim Shala

Me kontribut të hulumtuesve: Leotrim Gashi dhe Driton Nocaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Prill 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Rëndësia e respektimit të Kushtetutës, ligjit dhe të drejtave të njeriut në ushtrimin e autorizimeve publike.....	5
3. Paraqitja e pandemisë COVID-19 në Kosovë	7
4. Rrëzimi i Qeverisë në kohë pandemie	7
5. Vendimet e Qeverisë së Kosovës për masat parandaluese ndaj COVID-19	9
6. Analizë e bazës ligjore të vendimeve të Qeverisë së Kosovës	10
6.1. Vendimet jo kompetente	10
6.2. Vendimet pa bazë ligjore.....	11
6.3. Tejkalmi i autorizimeve ligjore të vendimeve të Qeverisë	12
7. Vendimi i Qeverisë së Kosovës për kufizimin e qarkullimit.....	13
8. Përfundimet e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.....	15
9. Vendimet e MSh-së pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese	16
10. Iniciativa ligjore për Projekt-Ligjin për Luftimin dhe Parandalimin e COVID-19	17
11. Përfundime	18
12. Rekomandime.....	20

1. Përmbledhje ekzekutive

Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimi i ligjit janë vlera kushtetuese në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, derisa mos respektimi i hierarkisë ligjore obligative dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë negacion i këtyre vlerave.

Për shkak të rritjes së numrit të infektuarve në shtete të ndryshme nga e gjithë bota, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) më 11 mars 2020, ka shpallur virusin korona që shkakton sëmundjen Covid-19 si pandemi në nivel global. Rastet e para me COVID-19 në Kosovë ishin konfirmuar më 13 mars 2020, derisa deri në ditën e publikimit të këtij raporti, në Kosovë janë të konfirmuar gjithsej 604 të infektuar me COVID-19, 128 prej të cilëve janë shëruar derisa 18 të tjerë kanë humbur jetën.

Për të parandaluar përhapjen e kësaj pandemie, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë kanë ndërmarrë një varg masash. Pavarësisht racionalitetit mjekësor të këtyre masave, në aspektin ligjor, në shumë raste këto vendime nuk përkojnë me vlerën e sundimit të ligjit, respektimit të Kushtetutës dhe ligjeve dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Gjetjet e IKD-së dëshmojnë se në shumë raste, vendimet e tilla janë marrë nga institucione jo-kompetente, pa bazë ligjore si dhe duke tejkaluar autorizimet ligjore, çfarë përbën një cenim të rëndë të parimit të hierarkisë ligjore në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Më 23 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte nxjerrë vendim për ndalimin e qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve private, i cili ndalim, sipas vendimit, ka filluar më 24 mars 2020.

Me kërkesë të Presidentit të Republikës së Kosovës, ky vendim ka qenë objekt i vlerësimit nga Gjykata Kushtetuese, e cila të njëjtin vendim e ka shfuqizuar, me arsyetimin se i njëjti nuk është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës.

Kërkesat kryesore të këtij aktgjykimi ishin që këto vendime duhet të nxirren nga Ministria e Shëndetësisë, dhe jo nga Qeveria, si dhe këto masa duhet të jetë të përcaktuara me ligj.

Përderisa kërkesa e parë është zbatuar, Ministria e Shëndetësisë përsëri ka nxjerrë vendime për të cilat nuk është e autorizuar me ligj.

Në anën tjetër, në mënyrë që këtyre masave të domosdoshme shëndetësore tu ipet legjitimitet dhe legalitet, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka proceduar nismën legjislative për projekt-ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e COVID-19 në Kosovë, i cili projekt-ligj ende ka mbetur në stadin e nismës legjislative.

2. Rëndësia e respektimit të Kushtetutës, ligjit dhe të drejtave të njeriut në ushtrimin e autorizimeve publike

Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimi i ligjit janë vlera që janë përcaktuar qartë edhe në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Në nenin 1 të Kushtetutës së Kosovës, në të cilin nen bëhet përkufizimi i shtetit, nënvizohet se *“2.Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj”*.

Sa i përket mandatit të Qeverisë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 4, në të cilin nen përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, ka përcaktuar se *“Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar”*.

Për të bërë balancën në mes të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe domosdoshmërisë në raste të caktuara për të ndërhyrë në këto të drejta, Kushtetuta e Kosovës ka përcaktuar dispozita për këto përjashtime, dhe e gjithë kjo me qëllim që në asnjë rrethanë, mos të cenohet esenca e një të drejte. Në këtë kuptim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar edhe dispozita të kufizimit dhe shmangies së të drejtave të njeriut, duke rregulluar materien dhe procedurën për këto kufizime dhe shmangie.

Pra, në raste të jashtëzakonshme, kalohet në respektimin e rregullave mbi kufizimin dhe shmangien e të drejtave të njeriut, por në asnjë rrethanë në anashkalim të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës.

Në rendin kushtetues kosovar, Kuvendi i Republikës së Kosovës është institucioni qendror, i cili veprimtarinë e vet e ushtron me anë të miratimit të ligjeve.

Por, në një aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kishte nënvizuar detyrimin e vet Kuvendit për të mbrojtur frymën dhe shkronjën e Kushtetutës me rastin e miratimit të ligjeve të caktuara¹.

Për këtë arsye, asnjë gjendje apo rrethanë nuk e shmangë respektimin e hierarkisë ligjore, të përcaktuar me Kushtetutë, por se një gjendje apo rrethanë e tillë, thjesht referon tek dispozitat e tjera të Kushtetutës.

¹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. *“Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Ligjit nr.06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë*. Rasti KO43/19. 27 qershor 2019. paragrafi 60.

Shembulli më i mirë në respektimin e rendit kushtetues dhe juridik në çfarë do gjendje gjendet tek negociatat kushtetuese franceze të vitit 2015, gjatë të cilit vit, Franca po përballej me një rrezik real nga terrorizmi. Gjatë këtyre negociatave, deputetët francezë ishin të gatshëm të heqin dorë nga disa të drejta të tyre themelore me qëllim të rritjes së sigurisë kombëtare, por jo edhe të vendosnin masa të cilat bien në kundërshtim me “parimet themeluese të Republikës Franceze”².

Pra, në rastin konkret, nuk bëhej fjalë për një dispozitë konkrete kushtetuese apo ligjore, por për thelbin e rendit kushtetues, të cilin thelb deputetët francezë nuk pranuan ta cenojnë, përkundër rrezikun ekzistencial.

Lidhur me materien e vendimeve, përkatësisht masat për luftimin dhe parandalimin e COVID-19 të përcaktuara nga Qeveria dhe MSh, ndërmarrja e këtyre masave është domosdoshmëri në luftën kundër COVID-19, dhe të njëjtat masa korrespondojnë edhe me rekomandimet e OBSH-së.

Por, para së gjithash, këto masa duhet të ndërmerren nga institucionet kompetente, dhe duke zbatuar në mënyrë strikte kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Në këtë linjë ka deklaruar edhe deputetja Tanja Fajon, duke theksuar njëkohësisht domosdoshmërinë e masave dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

“‘‘Sapo fola me ministrin kosovar të Shëndetësisë, Arben Vitia. Unë përkrah fuqishëm përpjekjet e tij kundër pandemisë COVID-19. Për ta evituar sëmundjen, njerëzit duhet të qëndrojnë në shtëpi. Ne u pajtuam që të gjithë masat duhet të jenë të kufizuara në kohë dhe në linjë me të drejtat themelore’’, ka shkruar Fajon”.

Lidhur me vendimet e Qeverisë për vendosjen e masave parandaluese ndaj COVID-19 ka reaguar edhe Raportuesja e Parlamentit Evropian për Kosovës, Viola Von Cramon, ku ka thënë se këto masa nuk janë në pajtim me Kushtetutën.

“Rregullat e izolimit duhet të jenë në pajtim me rregullat kushtetuese në Kosovë. Rregullat që krijojnë më shumë konfuzion dhe që s’kanë mundësi të zbatohen, do të bëjnë më shumë dëme. Qeveria duhet t’i kthehet bazës kushtetuese” ka deklaruar Von Cramon.

Lidhur me situatën e krijuar pas paraqitjes së kësaj pandemie, Këshilli i Evropës (KE) ka publikuar edhe parimet e të drejtave të njeriut që duhet të merren parasysh gjatë kësaj gjendje.

Në dokumentin e titulluar “Parimet e të drejtave të njeriut duhet të udhëzojnë vendimet shëndetësore, duke u tërhequr nga Konventa, Komiteti për Bioetikë rikujton një numër parimesh ligjore:

- qasja në kujdesin shëndetësor, në veçanti në kontekstin e burimeve të pakta, duhet të jenë të barabartë dhe të udhëhiqen nga kriteret mjekësore, për të siguruar se të udhëhequr nga

² Katalin Dobias. “*The role of constitutional identity in the responses to the terrorattacks in France and the refugee-management crisis in Hungary*”. Annual Review of Constitution-Building Processes: 2015, Sweden. 2016, f.106.

kriteret mjekësore, për të siguruar që njerëzit më të prekshëm, siç janë personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, refugjatët dhe emigrantët, nuk janë viktimë të diskriminimit;

- mbledhja dhe përpunimi i të dhënave lidhura me shëndetin, e cila është thelbësore në luftën kundër COVID-19, duhet t'i nënshtrohet kushteve specifike mbrojtëse;
- **kufizimet në ushtrimin e të drejtave duhet të përcaktohen me ligj** dhe të synojnë mbrojtjen e interesave kolektive, përfshirë shëndetin publik;
- kushte të veçanta mund të jenë të zbatueshme për raste urgjente klinike siç janë ato me të cilat përballen profesionistë të kujdesit shëndetësor në kontekstin e krizës COVID-19;
- të drejtat e personave që u janë nënshtruar hulumtimit, që synojnë zhvillimin e masave të duhura terapeutike dhe parandaluese, duhet të mbrohen (*Protokolli shtesë i Konventës Oviedo në lidhje me Hulumtimin biomjekësor përcakton kushtet në të cilat mund të bëhet hulumtimi mbi personat në situata klinike emergjente*).

3. Paraqitja e pandemisë COVID-19 në Kosovë

Për shkak të rritjes së numrit të personave të infektuar në shtete të ndryshme nga e gjithë bota, OBSH më 11 mars 2020, kishte shpallur virusin korona Covid-19 si pandemi në nivel global.

Deri në këtë datë, në Kosovë nuk ishte konfirmuar asnjë person si i infektuar me COVID-19.

Rastet e para me COVID-19 në Kosovë ishin konfirmuar me 13 mars 2020. Këtë e kishte bërë të ditur, Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, dhe Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, në një konferencë për media.

Deri në ditën e publikimit të këtij raporti, në Kosovë janë të konfirmuar gjithsej 604 të infektuar me COVID-19, 128 prej të cilëve janë shëruar derisa 18 të tjerë kanë humbur jetën.

4. Rrëzimi i Qeverisë në kohë pandemie

Pas një mocioni të mosbesimit të iniciuar në Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Kuvendi i Republikës së Kosovës me 25 mars 2020 ka miratuar këtë mocion, me ç'rast ka shkarkuar Qeverinë e Republikës së Kosovës

Pra, Qeveria e Kosovës është shkarkuar 12 ditë pas konfirmimit të rasteve të para me COVID-19, derisa në ditën e rrëzimit të Qeverisë, në Kosovë kanë qenë gjithsej 71 persona të infektuar, 1 prej të cilëve kishte ndërruar jetë.

Para votimit të këtij mocioni, duke vlerësuar që shëndeti publik dhe qetësia qytetare duhet të jenë imperativ për tërë spektrin politik, IKD dhe 11 Organizata të tjera të Shoqërisë Civile kanë

kërkuar nga liderët e partive që publikisht kanë përkrahur mocionin e mosbesimit që deri në mbajtjen eventuale të seancës, të bëhen të gjitha përpjekjet e nevojshme për arritjen e një marrëveshje politike për tejkalimin e situatës së tanishme.

“Kjo marrëveshje duhet të bazohet në parimin e funksionimit të pandërprerë të punës së ekzekutivit deri në tejkalimin e kësaj sfide, respektimin e të drejtës së deputetëve për votimin e mocionit pas një periudhe optimale, përfshirjes aktive të të gjitha partive në luftën kundër pandemisë nëpërmjet ofrimit të ekspertizave përkatëse, por edhe vazhdimin e mbikëqyrjes efektive të vendimeve tjera të ekzekutivit; Marrëveshja duhet të parashohë modalitete që respektojnë detyrimet kushtetuese që rrjedhin nga iniciativa e ndërmarrë nga më shumë se 40 deputetë për mbajtjen e seancës, por që nuk rezultojnë me votim të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë; Subjektet politike parlamentare mund të merren vesh që mocioni të hidhet në rend të ditës por që i njëjti të mos votohet së paku deri në një periudhë 90 ditore ose derisa të kalojë gjendja emergjente. Duke u siguruar që pas kësaj periudhe kur të krijohen rrethanat e përshtatshme për një veprim të tillë që respekton vullnetin e shumicës së deputetëve në Kuvend” thuhej në reagimin e këtyre Organizatave të Shoqërisë Civile.

Përpos kësaj, Ministritë e Jashtme të Gjermanisë dhe Francës po ashtu kishin kërkuar që për shkak të krizës shëndetësore, votimi i mocionit të rishqyrtohet apo të shtyhet.

“Kosovës i duhet një qeveri stabile dhe funksionale që të përballet me këtë krizë. Prandaj, ne ju bëjmë thirrje që votimi për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë të rishqyrtohet ose të shtyhet” thuhej në reagimin e përbashkët të këtyre dy ministrive.

Në anën tjetër, lidhur me mbajtjen e seancës për votimin e këtij mocioni votëbesimi, i kënaqur është shprehur ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett.

“I kënaqur të shoh kuvendin që ka vendosur të mbajë seancë nesër lidhur me mocionin e mosbesimit. Siç i thash edhe sot kryeministrit, është e rëndësishme që kuvendi dhe të gjitha institucionet e Kosovës të respektojnë Kushtetutën”, ka shkruar Kosnett në llogarinë e tij në Twitter.

5. Vendimet e Qeverisë së Kosovës për masat parandaluese ndaj COVID-19

Lidhur me masat parandaluese ndaj COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë një sërë vendimesh, ku disa prej më kryesoreve janë të paraqitura si më poshtë.

Ndër vendimet e para të Qeverisë së Kosovës që kanë të bëjnë me pandeminë COVID-19 është vendimi i 28 shkurtit 2020 për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 400.000 eurove për Ministrinë e Shëndetësisë (MSh) për parandalimin e situatave të ndryshme që lidhen me këtë pandemi.

Vendimi pasues i Qeverisë së Republikës së Kosovës i kësaj natyre ishte vendimi i datës 10 mars 2020, për aprovimin e planit për gatishmëri dhe reagim kundër Korona Virusit dhe Plani i Veprimit.

Me vendimin e datës 11 mars 2020, Qeveria e Kosovës me qëllim të parandalimit të pandemisë COVID-19, ka ndërprerë procesin edukativo-arsimor në nivel vendi, ka obliguar kontrollin e udhëtarëve në të gjitha hyrje-daljet e Kosovës, ka përcaktuar vetëkarantinimin e detyruar për të gjithë personat që hynë në Republikën e Kosovës etj.

Masat e tjera shtesë për parandalimin e pandemisë COVID-19, Qeveria e Kosovës i ka marrë me vendimin e datës 13 mars 2020, me anë të së cilit vendim, Qeveria kishte futur në karantinë komunat e Klinës dhe Vitisë, ka ndaluar transportin ndër-urban, ka pezulluar të gjitha linjat e udhëtimit ajror në aeroportin e Prishtinës, ka mbyllur kufijtë tokësor etj.

Pas konfirmimit të rasteve të para me COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës, me 15 mars 2020, ka nxjerrë vendim për shpalljen e gjendjes së emergjencës së shëndetit publik.

Me 18 mars 2020, Qeveria me anë të vendimit ka caktuar Qendrën e Studentëve në Prishtinë si hapësirë karantine.

Po ashtu, më 30 mars 2020, Qeveria ka nxjerrë vendim për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale.

6. Analizë e bazës ligjore të vendimeve të Qeverisë së Kosovës

Vendimet e Qeverisë së Kosovës të cilat janë nxjerrë në përgjigje ndaj situatës së krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19 janë vendime me një numër të madh të të metave sa i përket aplikimit të bazës ligjore.

Në këtë drejtim, IKD ka analizuar të gjitha këto vendime të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjetjet e IKD-së tregojnë fillimisht se Qeveria e Republikës së Kosovës në vendimet e saja nuk i ka kushtuar fare rëndësi bazës ligjore sipas të cilës janë nxjerrë këto vendime. Në shumicën e këtyre vendimeve, baza e aplikuar ligjore është një “shabllon” i dispozitave të përgjithshme, duke mos përcaktuar bazën e saktë ligjore mbi të cilën nxjerrët një vendim, apo thënë më ndryshe, duke mos specifikuar se një vendim i Qeverisë, cilin ligj e zbaton në praktikë.

Duke vepruar në këtë mënyrë, IKD ka gjetur se Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendime për të cilat nuk ka qenë kompetente, derisa krahas cenimit të kompetencës dhe aplikimit “shabllon” të bazës ligjore, IKD gjen se Qeveria e Republikës së Kosovës ka tejkaluar edhe autorizimet e saja ligjore, duke vendosur për çështje të cilat janë në kompetencë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këto gjetje të IKD-së janë të trajtuara në rreshtat pasues, derisa përjashtim nga kjo analizë bënë vendimi për kufizimin e lirisë së lëvizjes, i cili vendim është trajtuar në një kapitull të veçantë në këtë raport.

6.1. Vendimet jo kompetente

Neni 41 i Ligjit nr.02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse përcakton se “Për ta parandaluar futjen dhe përhapjen e kolerës, murtajës, variola vera, etheve hemorragjike virale, etheve të verdha, SARS-it, gripit të shpendëve dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse në tërë vendin, **Ministria e Shëndetësisë, me akte nënligjore përcakton masat e posaçme të jashtëzakonshme për mbrojtje nga këto sëmundje**, si vijon....”.

Ndërsa, neni 89 i Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi përcakton se “Zbatimi i kujdesit shëndetësor gjatë gjendjes së emergjencës **sigurohet nga ana e Ministrisë** në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi”.

Në anën tjetër, Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas Ligjit nr.02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse ka të drejtën që të njoftohet nga Ministria e Shëndetësisë, derisa ka kompetencë dhe detyrë për të siguruar mjete materiale shtesë për raste emergjente. Po ashtu, neni 90 i Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi përcakton se “1. Qeveria, organizon, përgatit, dhe financon aktivitetet për realizimin e kujdesit shëndetësor në rrethana të gjendjes së jashtëzakonshme. 2.Aktivitetet përgatitore të Qeverisë për sigurimin e kujdesit shëndetësor gjatë gjendjes së jashtëzakonshme përfshijnë: 2.1. sigurimin e aktiviteteve planifikuese; 2.2.

përcaktimin e strukturave të udhëheqjes; 2.3.përcaktimin e detyrimit të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve sektoriale dhe komunale; 2.4. zhvillimin e rregullativës ligjore dhe administrative;2.5. sigurimin e stoqeve të medikamenteve dhe të materialit shpenzues medicinal; 2.6. ripërtirjen e rezervave shtetërore për shëndetësi, deri në masën e nevojshme; 2.7. sigurimin e trajnimeve për shërbimet e kujdesit shëndetësor përkitazi me gjendjet e jashtëzakonshme”.

Pra, sa i përket vendimeve që kanë të bëjnë me caktimin e masave parandaluese ndaj COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka pasur fare kompetencë të marrë këto vendime. Kjo pasi bazuar në dy ligjet e trajtuara në këtë pjesë, këto kompetenca sipas ligjit i takojnë ekskluzivisht Ministrisë së Shëndetësisë.

Nga ky qëndrim, përjashtim bëjnë vetëm vendimet që kanë të bëjnë me ndarjen e mjeteve financiare për përballjen me pandeminë COVID-19.

6.2. Vendimet pa bazë ligjore

Në një sërë vendimesh që ka marrë Qeveria e Republikës së Kosovës përkitazi me vendosjen e masave parandaluese për COVID-19, i referohen dispozitave të përgjithshme mbi rolin dhe kompetencat e Qeverisë.

Pika 4 e nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se Qeveria “merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve”.

Krahas nenit 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, këto vendime si bazë ligjore të përgjithshme kanë aplikuar kryesisht edhe nenin 4 të Rregullores nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit³ dhe Ministrive dhe nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011⁴.

Por, në këto vendime, Qeveria e Republikës së Kosovës si bazë ligjore e ka përdorur vetëm këtë nen, dhe nene të ngjashme të akteve nënligjore, duke mos përcaktuar se me anë të këtij vendimi, cili ligj zbatohet.

Vendimet në të cilat është aplikuar vetëm baza e përgjithshme dhe jo ligji i cili zbatohet me anë të këtij vendimi janë: vendimi nr.01/07 i datës 11 mars 2020, vendimi nr.04/06 i datës 10 mars 2020 dhe vendimi nr.01/16 i datës 26 mars 2020.

³ Ky nen përcakton se: “1. Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. 2. Qeveria me qëllim të ushtrimit të kompetencave të saj:2.1. merr vendime me propozimin e anëtarëve të Qeverisë dhe institucioneve të tjera në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;2.2. nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;2.3. diskuton probleme dhe merr vendime për çështje të tjera që ajo i konsideron të rëndësishme në kuadër të kompetencave të saj; 2.4. vendosë për emërimet dhe shkarkimet brenda kompetencave të saj, si dhe2.5.kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi”.

⁴ Ky nen në paragrafin 1 përcakton se: “Qeveria mund të miratojë vendime, nëse më parë janë përgatitur në pajtim me këtë Rregullore”, derisa paragrafët pasues përcaktojnë procedurën e nxjerrjes së vendimeve.

Madje, duke aplikuar vetëm bazë të përgjithshme ligjore dhe duke mos u thirrur në ligje që zbatohen sipas vendimit, Qeveria ka nxjerrë edhe vendimin për miratimin e Pakos Emergjente Fiskale. Në këtë mënyrë, ky vendim nuk përmban ndonjë bazë ligjore e cila do të përcaktonte të drejtën e Qeverisë për të ndarë këto mjete buxhetore siç është përcaktuar me pakon Emergjente, që kapin vlerën prej 179,650,000.00 euro.

Pra, aplikimi i normave të përgjithshme mbi rolin dhe kompetencat e qeverisë si bazë ligjore, duke mos treguar se me këto vendime cili ligj zbatohet, nënkupton se këto vendime të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë vendime pa bazë ligjore, pasi baza ligjore e aplikuar është vetëm formale.

6.3. Tejkalmi i autorizimeve ligjore të vendimeve të Qeverisë

Me 13 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës me anë të vendimit nr.01/09 ka aprovuar Pakon Emergjente Fiskale.

Ky vendim i Qeverisë në detyrë përpos që përmban vetëm dispozita të tipit të përgjithshëm lidhur me vendimmarrjes e saj kushtetuese në zbatueshmërinë e ligjit, nuk përmban ndonjë bazë ligjore e cila do të përcaktonte të drejtën e Qeverisë për të ndarë këto mjete buxhetore siç është përcaktuar me pakon emergjente, që kapin vlerën prej 179,650,000.00 euro.

Një planifikim i tillë buxhetor bie në kundërshtim fillimisht me nenin 65, paragrafi 5 të Kushtetutës së Kosovës [Kompetencat e Kuvendit-Miraton buxhetin e Republikës së Kosovës], e pastaj edhe me Ligjit nr. 07/l-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 dhe Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Në bazë të nenit 4 dhe 5 të Ligjit për Buxhetin, parashihet që buxheti miratohet nga Kuvendi, së bashku me tabelat 3.1.,3.1.A., 3.1.B., 3.2., 3.2.B., 4.1., 4.2. dhe 4.3., të bashkangjitura me këtë ligj, në të cilat tabela bëhet edhe ndarja buxhetore. Mirëpo në këto tabela nuk janë të parapara shpenzimet të cilat janë parashikuar të bëhen nga buxheti i shtetit me Pakon Emergjente Fiskale.

Po ashtu në bazë të nenit 22A dhe 22 B të ligjit nr. 04/l-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr.03/l221 dhe nr.04/l-116, nuk lejohet që asnjë ligj të tejkaloj deficitin mbi 2% të Bruto Produktit Vendor. (BPV)

Sipas paragrafit 1 të nenit 22B të këtij ligji, Kuvendi mundet të rrisë kufirin e deficitit nëse shfaqet ndonjë ngjarje apo kombinim i ngjarjeve, duke përfshirë rastin kur pasojat e specifikuara financiare dhe ekonomike parashikohet të kenë ndikim të madh në buxhetin e përgjithshëm në vitin fiskal kur shfaqen ato ngjarje apo në vitin fiskal pasues, konkretisht, në pikën 2 të këtij paragrafi thuhet, *“në rast të gjendjes së jashtëzakonshme brenda kuptimit të nenit 131.1. të Kushtetutës, përfshirë këtu ndonjë katastrofë natyrore.”*

Pra, ashtu edhe siç parashihet me nenin 65 të Kushtetutës së Kosovës, vetëm Kuvendi miraton buxhetin e Kosovës dhe ai edhe duhet ta mbikëqyrë atë dhe në këtë mënyrë parashihet se rritja e deficitit buxhetor mund të ndodhë në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të katastrofave natyrore.

Edhe me shtojcën 1, të Ligjit nr. 07/l-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës të Kosovës për vitin 2020, është thënë se *“si rrjedhojë e zhvillimeve politike në 2019 si dhe aprovimit të vonshëm të Buxhetit 2019, në përputhje me rregullën fiskale, deficitin buxhetor për vitin 2019 arriti Euro 25 milionë, apo rreth 0.3% e BPV-së. Ndërsa për vitin 2020 si rrjedhojë e rritjes së nevojës së financimit për shpenzimet rrjedhëse dhe të shpenzimeve kapitale, deficitin buxhetor pritet të jetë 147 milionë euro, apo rreth 2.0% e BPV-së, për të vazhduar me një ritëm të ngjashëm në vlerën 1.7 % në vitin 2021 dhe 1.9% në 2022”*

Në bazë të kësaj, akoma pa u vendosur për pakon emergjente fiskale, është paraparë se në vitin 2020, deficitin buxhetor të jetë 147 milionë euro apo rreth 2% e BPV-së, ndërsa vetëm me Pakon Emergjente Fiskale të miratuar nga Qeveria në detyrë janë paraparë të ndahen 179,650,000.00 euro, që tejkalon deficitin e shpenzimeve shtetërore.

Për këto arsye, IKD konsideron se masat e përcaktuara me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Pakos Emergjente Fiskale, janë bërë në kundërshtim me ligjet e lartcekura dhe në mënyrë që ato të vlenin do të duhej të ishin bërë ose përmes plotësimit ndryshimit të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ose përmes rishikimit të buxhetit nga ana e Kuvendit.

Pra duke vepruar në këtë mënyrë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendim për të cilin është i autorizuar vetëm Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe për nxjerrjen e të cilit vendim në këtë mënyrë, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka autorizim ligjor.

Në këtë mënyrë, me këtë vendim, IKD vlerëson se Qeveria ka tejkaluar autorizimet e saja ligjore.

7. Vendimi i Qeverisë së Kosovës për kufizimin e qarkullimit

Me 23 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte nxjerrë vendim për ndalimin e qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve private, i cili ndalim, sipas vendimit, ka filluar me 24 mars 2020. Sipas këtij vendimi, ndalohet qarkullimi i qytetarëve dhe automjeteve private gjatë orës 10:00 – 16:00 dhe gjatë orës 20:00-06:00, i cili orar ishte ndryshuar me vendimin e Qeverisë

së Kosovës të datës 27 mars 2020, sipas të cilit ndalohet qarkullimi i qytetarëve dhe automjeteve private gjatë orës 17:00-06:00.

Në ditën e nxjerrjes së këtij vendimi, Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, kishte mbajtur një konferencë për media, në të cilën konferencë kishte bërë thirrje për mos zbatimin e këtij vendimi, thirrje e cila përbën vepër penale sipas nenit 403 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës⁵.

Po ashtu, të nesërmen, Presidenti i Republikës së Kosovës kishte atakuar këtë vendim në Gjykatën Kushtetuese të Republikës, me pretendimet se vendimi i Qeverisë cenon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

Sipas kërkesës së Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, këto kufizime të të drejtave të njeriut mund të bëhen vetëm pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe me pëlqimin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përgjigja e Qeverisë së Republikës së Kosovës përkitazi me këtë kërkesë të presidentit ishte se kjo kërkesë nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, si dhe me anë të këtyre komenteve, Qeveria e Kosovës kishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që këtë kërkesë ta hudhë poshtë si qartazi të pabazuar.

Me 31 mars 2020, Gjykata Kushtetuese me anë të një komunikate ka njoftuar se kjo Gjykatë ka vendosur që **I. TË DEKLAROJË** kërkesën të pranueshme; **II. TË SHPALLË** që Vendimi nr. 01/15 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 23 marsit 2020, nuk është në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E drejta e Privatësisë] dhe 43 [Liria e Tubimit] të Kushtetutës, me nenet 8 (E drejta e jetës private dhe familjare) e 11 (Liria e tubimit dhe asociimit) të KEDNJ-së dhe me nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ; **III. TË KONSTATOJË** që neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] i Kushtetutës nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret sepse nuk kemi të bëjë me “shmangie” nga të drejtat dhe liritë themelore; **IV. TË KONSTATOJË** që, bazuar në nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhet “vetëm me ligj” të Kuvendit të Republikës së Kosovës; **V. TË SHPALLË** të pavlefshëm, në pajtim me nenin 116.3 të Kushtetutës, Vendimin e cekur në pikën II të këtij dispozitivi, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi; **VI. T’UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve**; **VII. Ky aktgjykim**, në pajtim me nenin 116.3 të Kushtetutës, nenin 20.5 të Ligjit dhe rregullin 60 (5) të

⁵ “Deklarata e Presidentit Thaçi për mos zbatim të vendimit të qeverisë paraqet vepër penale dhe shkelje të rëndë të kushtetutës”. “Betimi për Drejtësi”, publikuar më 25 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarata-e-presidentit-thaci-per-mos-zbatim-te-vendimit-te-qeverise-paraqet-veper-penale-dhe-shkelje-te-rende-te-kushtetutes/>).

Rregullores së punës, **hyn në fuqi më 13 prill 2020**; dhe VIII. **TË PUBLIKOJË** këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit”.

Aktgjykimi i plotë i Gjykatës Kushtetuese është publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate më, 6 prill 2020.

8. Përfundimet e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese

Pas shqyrtimit meritor të kërkesës dhe para dispozitivit, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka paraqitur përfundimet e saja përkitazi me vlerësimin e kërkesës së Presidentit të Republikës së Kosovës.

Si përfundim, kjo Gjykatë konstatoi se kufizimet që përmban vendimi i kontestuar i Qeverisë përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të lartcekura, nuk janë të “përcaktuara me ligj”, andaj bien në kundërshtim me garancitë që përmbajnë nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në lidhje me nenet respektive të KEDNJ-së, dhe me nenin 55 të Kushtetutës, i cili në paragrafin e tij të parë përcakton qartë që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

Sa i përket Ligjit nr.02/L-109 për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi, Gjykata Kushtetuese në këtë rast vlerëson se zbatimi i këtyre dy ligjeve bëhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe jo nga Qeveria. Kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe lirisë së tubimit, sipas këtij aktgjykimi, nuk është i bazuar në asnjë autorizim të përcaktuar me këto ligje.

“Gjykata sqaroi se Qeveria nuk mund të kufizojë asnjë të drejtë dhe liri themelore përmes vendimeve, nëse një kufizim i të drejtës përkatëse nuk është paraparë me ligj të Kuvendit. Qeveria vetëm mund të zbatojë një ligj të Kuvendit që kufizon një të drejtë dhe liri themelore dhe atë vetëm deri në masën specifike që e ka autorizuar Kuvendi përmes ligjit përkatës” thuhet në përfundimet e këtij aktgjykimi.

Për më tepër, arsyetimi i këtij aktgjykimi jep edhe një test për të vlerësuar nëse një e drejtë e caktuar mund të kufizohet nga vendimet ekzekutive apo jo. Sipas këtij aktgjykimi, në secilin rast vlerësimi i hapave të këtij testi është kumulativ, që nënkupton se përgjigja negative në njërën pyetje, pamundëson kalimin në pyetjen e radhës, pasi kufizimi konsiderohet jo-kushtetues. Katër pyetjet e këtij testi sipas këtij aktgjykimi janë: 1). A ka qenë kufizimi i një të drejte apo lirie të garantuar me Kushtetutë “i përcaktuar me ligj”? 2) A ka ndjekur kufizimi i një të drejte apo lirie të caktuar një qëllim legjitim, respektivisht përmes kufizimit në fjalë, a përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi?, 3) A ka qenë kufizimi i një të drejte apo lirie të caktuar proporcional, respektivisht a është bërë kufizimi vetëm deri në masën sa ka qenë e domosdoshme? dhe 4) A është kufizimi i bërë i nevojshëm në një shoqëri të hapur dhe demokratike?

Pra, sipas Gjykatës Kushtetuese, parakushti fillestar është “përcaktimi me ligj” i një kufizimi të caktuar të të drejtave kushtetuese.

9. Vendimet e MSh-së pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese

Pas nxjerrjes së këtij aktgjykimi nga Gjykata Kushtetuese, Qeveria e Republikës së Kosovës, me 8 prill 2020 ka nxjerrë vendim me anë të së cilit ka autorizuar Ministrin e MSh-së për të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit të pandemisë COVID-19, në zbatim të Ligjit nr.02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

Paraprakisht, kemi trajtuar faktin se për këto vendime Qeveria e Kosovës nuk është fare kompetente që të vendosë, por është MSh.

Andaj, për këtë arsye, IKD vlerëson se është e pakuptueshme nxjerrja e një vendimi për “autorizimin” e një institucioni të autorizuar sipas ligjit, me kompetenca të cilat autorizuesi në këtë rast nuk i posedon. Pra, sipas këtij vendimi, subjekti pa autorizime, ka autorizuar subjektin me autorizime.

Sidoqoftë, vendimet e reja që kanë të bëjnë me caktimin e masave për parandalimin e COVID-19 janë nxjerrë nga Ministri i MSh-së, çfarë paraqet edhe zbatim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Por, kufizimet që janë bërë, janë kufizime të cilat nuk e kalojnë fazën e parë të testit mbi kufizimin e të drejtave të njeriut, pasi të njëjtat kufizime, *“nuk janë të parapara me ligj”*.

Me 14 prill 2020, Ministri i MSh-së, Arben Vitia, ka nxjerrë gjithsej 38 vendime identike, por të ndara për secilën komunë veç e veç.

Me anë të këtyre vendimeve, MSh ka kufizuar lëvizjen e qytetarëve dhe automjeteve në nivel të gjithë Republikës së Kosovës, përjashtimisht të drejtës së qytetarëve që sipas orarit të përcaktuar nga MSh sipas numrit të parafundit personal, të qarkullojnë për 90 minuta brenda ditës. Në këto vendime, janë përcaktuar edhe përjashtimet e tjera specifike.

Për nxjerrjen e këtyre vendimeve, MSh i është referuar nenit 41.2 të Ligjit nr.02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, i cili nen i jep MSh-së autorizim për të vendosur për të marrë vendim lidhur me *“Ndalimin e qarkullimit në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara”*.

Lidhur me këtë vendim, IKD vlerëson se nxjerrja e këtyre vendimeve në këtë mënyrë nuk paraqet zbatim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pasi për kufizimin e qarkullimit në nivel vendi, MSh nuk ka autorizim me ligj.

Autorizimi për të ndaluar qarkullimin i është dhënë MSh-së me ligj vetëm për rajone të infektuara apo drejtpërsëdrejti të rrezikuara dhe jo edhe në nivel vendi. Mënyrë teknike e ndërtimit të këtij vendimi, duke i ndarë vendimet identike për secilën komunë, nuk paraqet zbatim të këtij të këtij neni, dhe as zbatim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo pasi vendimet janë individuale, por nga efekti juridik, bëhet fjalë për një vendim të përgjithshëm.

Për këto arsye, IKD konsideron se MSh me anë të këtyre vendimeve ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, i cili përcakton se për secilin kufizim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, parashikueshmëria me ligj e një kufizimi të tillë është kusht esencial, pa plotësimin e të cilit, nuk mund të vazhdohet tutje.

Në anën tjetër, në bazën ligjore të këtyre vendimeve është cekur edhe neni 145, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili nen nuk ka të bëjë fare me këtë situatë.

10. Iniciativa ligjore për Projekt-Ligjin për Luftimin dhe Parandalimin e COVID-19

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Qeverisë për kufizimin e lëvizjes, kjo Gjykatë ka përcaktuar se kufizimi i të drejtave të njeriut duhet të jetë i përcaktuar me ligj, derisa jo në secilin rast është e nevojshme shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme.

“Gjithsesi, lidhur me mos-pajtimin e palëve në kontest, Presidentit dhe Qeverisë, rreth kuptimit të termeve kushtetuese “kufizim” dhe “shmangie” që figurojnë në nenet 55 dhe 56 të Kushtetutës, Gjykata qartësoi se “kufizimi” i të drejtave dhe lirive të njeriut mund të bëhet “vetëm me ligj” të Kuvendit, por kjo nuk do të thotë që “kufizimi” i të drejtave, mund të bëhet vetëm përmes dhe pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Gjykata po ashtu sqaroi se termi “kufizim” i përdorur në nenin 55 të Kushtetutës nënkupton faktin që Kuvendi ka të drejtë të kufizojë të drejta dhe liri themelore, përmes ligjit, por vetëm për aq sa dhe deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Thënë ndryshe, “kufizimi” nënkupton një shkallë më të lehtë të ndërhyrjes dhe kjo mund të bëhet edhe pa shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme; ndërkaq “shmangia” nënkupton një shkallë më të rëndë të ndërhyrjes ngase nuk mund të bëhet kurrësi pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme”, thuhet në këtë aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në këtë kuptim, për shkak të situatës aktuale dhe rrezikut që ju kanoset shëndetit të qytetarëve, caktimi i masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, masa këto që konsistojnë në kufizimin e të drejtave të njeriut, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të miratojë një ligj të veçantë, me qëllim të dhënies së legalitetit këtyre masave.

Më 15 prill 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka njoftuar se Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka procedurë nismën legjislative për Projekt-ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e COVID-19 në Kosovë.

“Kjo nismë është iniciuar si rrjedhojë e kërkesave të cilat burojnë nga Aktgjykimi KO 54/20 i Gjykatës Kushtetuese, i datës 6 prill 2020, i cili specifikon rolin e Kuvendit në ndërmarrjen e masave të duhura për tu siguruar që kufizimet e nevojshme të të drejtave dhe lirive themelore më qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, janë bërë në pajtueshmëri me Kushtetutën”, thuhet në njoftimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

IKD vlerëson se legjitimiteti dhe legaliteti i këtyre masave kthehet vetëm me miratimin e një ligji të veçantë që përcakton këto masa, apo që i jep autorizim Qeverisë apo MSh-së për të vendosur këto masa të tilla.

Për këtë arsye, bazuar në gjendjen shëndetësore dhe rrezikimin e shëndetit publik për shkak të shfaqjes së pandemisë COVID-19, IKD rekomandon që ky projekt-ligj të trajtohet me urgjencë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mënyrë që vendimet e qeverisë për parandalimin e kësaj pandemie, të jetë legjitime dhe ligjore.

11. Përfundime

- Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimi i ligjit janë vlera kushtetuese në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.
- Për të bërë balancën në mes të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe domosdoshmërisë në raste të caktuara për të ndërhyrë në këto të drejta, Kushtetuta e Kosovës ka përcaktuar dispozita për këto përjashtime, dhe e gjithë kjo me qëllim që në asnjë rrethanë, mos të cenohet esenca e një të drejte. Në këtë kuptim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar edhe dispozita të kufizimit dhe shmangies së të drejtave të njeriut, duke rregulluar materien dhe procedurën për këto kufizime dhe shmangie. Pra, në raste të jashtëzakonshme, kalohet në respektimin e rregullave mbi kufizimin dhe shmangien e të drejtave të njeriut, por në asnjë rrethanë në anashkalim të kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës.
- Shembulli më i mirë në respektimin e rendit kushtetues dhe juridik në çfarë do gjendje gjendet tek negociatat kushtetuese franceze të vitit 2015, gjatë të cilit vit, Franca po përballej me një rrezik real nga terrorizmi. Gjatë këtyre negociatave, deputetët francezë ishin të gatshëm të heqin dorë nga disa të drejta të tyre themelore me qëllim të rritjes së sigurisë kombëtare, por jo edhe të vendosnin masa të cilat bien në kundërshtim me “parimet themeluese të Republikës Franceze”.
- Lidhur me masat parandaluese ndaj COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë një sërë vendimesh, të cilat një për një janë analizuar nga IKD.

- Gjetjet e IKD-së tregojnë fillimisht se Qeveria e Republikës së Kosovës në vendimet e saja nuk e ka kushtuar fare rëndësi bazës ligjore sipas të cilës janë nxjerrë këto vendime. Në shumicën e këtyre vendimeve, baza e aplikuar ligjore është një “shabllon” i dispozitave të përgjithshme, duke mos përcaktuar bazën e saktë ligjore mbi të cilën nxjerrët një vendim, apo thënë më ndryshe, duke mos specifikuar se një vendim i Qeverisë, cilin ligj e zbaton në praktikë.
- Duke vepruar në këtë mënyrë, IKD ka gjetur se Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendime për të cilat nuk ka qenë kompetente, derisa krahas cenimit të kompetencës dhe aplikimit “shabllon” të bazës ligjore, IKD gjen se Qeveria e Republikës së Kosovës ka tejkaluar edhe autorizimet e saja ligjore, duke vendosur për çështje të cilat janë në kompetencë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për kufizimin e lirisë së lëvizjes. Sipas kësaj gjykate, në secilin rast të kufizimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, duhet të vlerësohet nëse një kufizim i tillë “është i përcaktuar me ligj”.
- Pas nxjerrjes së këtij aktgjykimi nga Gjykata Kushtetuese, Qeveria e Republikës së Kosovës me 8 prill 2020 ka nxjerrë vendim me anë të së cilit ka autorizuar Ministrin e MSh-së për të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit të pandemisë COVID-19, në zbatim të Ligjit nr.02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse. IKD vlerëson se është e pakuptueshme nxjerrja e një vendimi për “autorizimin” e një institucioni të autorizuar sipas ligjit, me kompetenca të cilat autorizuesi në këtë rast nuk i posedon. Pra, sipas këtij vendimi, subjekti pa autorizime, ka autorizuar subjektin me autorizime.
- Me 14 prill 2020, Ministri i MSh-së, Arben Vitia, ka nxjerrë gjithsej 38 vendime identike, por të ndara për secilën komunë veç e veç. Me anë të këtyre vendimeve, MSh ka kufizuar lëvizjen e qytetarëve dhe automjeteve në nivel të gjithë Republikës së Kosovës, përjashtimisht të drejtës së qytetarëve që sipas orarit të përcaktuar nga MSh sipas numrit të parafundit personal, të qarkullojnë për 90 minuta brenda ditës. Në këto vendime, janë përcaktuar edhe përjashtimet e tjera specifike.
- Lidhur me këtë vendim, IKD vlerëson se nxjerrja e këtyre vendimeve në këtë mënyrë nuk paraqet zbatim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pasi për kufizimin e qarkullimit në nivel vendi, MSh nuk ka autorizim me ligj.
- Sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Qeverisë për kufizimin e lëvizjes, kjo Gjykatë ka përcaktuar se kufizimi i të drejtave të njeriut duhet të jetë i përcaktuar me ligj, derisa jo në secilin rast është e nevojshme shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme.
- Më 15 prill 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka njoftuar se Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka procedurë nismën legislative për Projekt-ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e COVID-19 në Kosovë.
- IKD vlerëson se legjitimiteti dhe legaliteti i këtyre masave kthehet vetëm me miratimin e një ligji të veçantë që përcakton këto masa, apo që i jep autorizim Qeverisë apo MSh-së

për të vendosur këto masa të tilla. Për këtë arsye, bazuar në gjendjen shëndetësore dhe rrezikimin e shëndetit publik për shkak të shfaqjes së pandemisë COVID-19, IKD rekomandon që ky projekt-ligj të trajtohet me urgjencë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mënyrë që vendimet e qeverisë për parandalimin e kësaj pandemie, të jetë legjitime dhe ligjore.

12. Rekomandime

1. Qeveria e Kosovës ta kuptojë drejt rolin e saj, në atë mënyrë që në nxjerrjen e secilit vendim të respektojë Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.
2. Qeveria e Kosovës në secilin vendim të respektojë kompetencën e përcaktuar me ligj për nxjerrjen e një vendimi të caktuar.
3. Qeveria e Kosovës t'i shmanget shablloneve të vendimeve në fushën e referimit të bazës ligjore.
4. Qeveria e Kosovës në vendimet e saja, mos të tejkaloj autorizimet ligjore.
5. Qeveria e Kosovës të respektojë në plotësi vendimin e Gjykatës Kushtetuese përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit për kufizimin e lëvizjes.
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës të miratojë në procedurë të përshpejtuar Ligjin për Luftimin dhe Parandalimin e COVID-19.
7. Në ndërmarrjen e masave parandaluese ndaj COVID-19, institucionet e Republikës së Kosovës të respektojnë parimet e publikuara nga Këshilli i Evropës, Komiteti për Bioetikë.